



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:048642

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06893669

C. nr. 68/2023

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj në çështjen juridike të paditëseve E.M.nga Malisheva dhe B.M.nga fshati P., me vendbanim në Malishevë në L.M., të cilët i përfaqëson Faik Morina avokat nga Malisheva, kundër të paditurit Q.M.nga Malisheva, për pengim posedim drejtës së servitutit të kalimit, jashtë shqyrtimit kryesor me datë 24.02.2025, merr këtë:

AKTVENDIM

Konstatohet se është Tërhequr padia e paditëseve E.M.dhe B.M., e ushtruar me datë 23.02.2023 kundër të paditurit Q.M.për pengim posedim drejtës së servitutit të kalimit.

A r s y e t i m

Paditësit e lartpërmendur me datë 23.02.2023, në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tyre Faik Morina avokat nga Malisheva, kanë parashtruar padinë ndaj të paditurit si më lartë për pengim posedim drejtës së servitutit të kalimit.

I autorizuari i paditëseve me datë 21.10.2024, ka deponuar parashtrësën me të cilën njofton gjykatën se tërheq padinë për paditësit E.M.dhe B.M.pasi që paditësit me vetë dëshirë dhe në koordinim me të paditurin Q.M.kanë rregulluar mosmarrëveshjet dhe këtë çështje e kanë rregulluar me marrëveshje. Tani pasi që në mes palëve në procedurë nuk ka ndonjë kontest dhe i cili kontest është rregulluar me marrëveshje në mes të palëve në procedurë, atëherë paditësit e tërheqin padinë.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës konform nenit 261 parg. 1, 3, 4 dhe 5 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë,
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C. nr. 68/2023, datë 24.02.2025.**

G j y q t a r i
Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet parashtrimi i ankesës,